**VENDIM**
**Nr. 186, datë 27.3.2024**

# PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 188, DATË 13.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR OFRIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË TË SHËRBIMEVE, NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E TYRE, PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 95, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 188, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësi të tyre dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.".

b) Pika 1 e vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si: konsulenca, studime, ekspertiza apo trajnime/edukim në vazhdim nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**